

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Klina – Raporti komunal

Tetor 2009

Klina në shifra

Popullsia	Gjithsej	55740
	Shqiptarë	99.6%
	Të tjerë	0.4%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	308.8
	Numri i fshatrave	54
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	17.87%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	42.73%
	E mesme	31.86%
	Shkollë e lartë	6.63%
	Universitet	0.92%
	Nr. i nxënësve	10555
	Nr. i mësimdhënësve	550
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	2
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	26
	Nr. i çerdheve	1
Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	13
	Nr. i mjekëve	32
Papunësia	Gjithsej	67.20%
	Meshkuj	57.53%
	Femra	86.67%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	34,001
	Të punësuar në sektorin publik komunal	937
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	4,996,631
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	685,000
	Të hyrat tjera (Euro)	4,311,631
Shpenzimet e realizuara (2008) ¹	Gjithsej (Euro)	4,404,910 (93%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	1,073,551 (83%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	3,331,359 (96%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	33.80%
	LDK	22.98%
	AAK	18.75%
	LDD	11.37%
	PDKI	3.51%
	PSHDK	3.49%
	AKR	3.06%
	Tjera	1.35%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Ramë Manaj (LDK) 2002-2007: Prenk Gjetaj (LDK) 2007-2009: Sokol Bashota (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Klinën

Edhe pse një komunën relativisht me territor të vogël, Klina ka shumë karakteristika të veçanta. Me një sipërfaqe prej 308.8 km² (për nga sipërfaqja Klina zë vendin e 19 në krahasim me komunat tjera), Klina kufizohet me shtatë komuna: Pejën, Istogun, Skenderajn, Drenasin, Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën. Përveç faktit se kufizohet me një numër të madh të komunave, nëpër territorin e kësaj komune kalojnë 5 lumenj, numri më i madh i lumenjve që kalojnë në një komunë në Kosovë. Nëpër territorin e Klinës kalojnë këta lumenj: Drini i Bardhë, lumi i Pejës, lumi Klina, lumi Mirusha dhe lumi i Istogut. Një nga atraksionet më të bukura natyrore të Klinës dhe të Kosovës, janë edhe ujëvarat e Mirushës. Mirëpo, për shkak të mungesës së përkujdesjes institucionale, qasja rrugore deri tek ujëvarat e Mirushës është shumë vështirë të arrihet, sidomos në kohë të dimrit. Në komunën e Klinës bashkëjetojnë komunitet të ndryshme fetare, më të mëdhatë komuniteti mysliman dhe ai katolik. Klina njihet për tolerancë të lartë fetare.

Problemet aktuale

Gjatë luftës së fundit të 1999, Klina pati humbje në jetë njerëzish dhe në pasuri të paluajtshme. Shumë biznese u mbyllën dhe shumë shtëpi u shkatërruar. Rindërtimi i pas luftës ishte i vështirë dhe i ngadalshëm. Klina, si tërë komunat e Kosovës, përballet me papunësi të lartë dhe gjendje të varfërisë. Me 67.2% të popullsisë së papunë, Klina radhitet e dyta pas Skenderajt për numrin e lartë të të papunëve. 1,115 familje me 5,178 anëtarë janë të varura nga ndihmat sociale. Nëse e llogarisim me numrin e popullsisë, i bie se 9.2% e popullsisë janë të varur nga ndihmat sociale. Përveç problemeve të papunësisë dhe varfërisë, problemet tjera me të cilat përballen qytetarët e kësaj komune janë edhe:

- Mungesa e ujit të pijes;
- Mungesa e stacionit të autobusëve;
- Shërbimet komunale;
- Ndotja e ambientit dhe mbeturinat;
- Mungesa e ndriçimit publik në qytet.

Mungesa e ujit të pijes paraqet një ndër problemet më shqetësuese të qytetarëve të komunës së Klinës. Kjo komunë ka pesë lumenj por nuk ka asnjë burim të ujit të pijshëm. Deri më tani, Klina furnizohet me ujë nga burimi i njohur si "Pusi i Jarinës", burim ky që ka një sasi të madhe uji, por uji që merret nga ky burim nuk është i pijshëm. Sipas analizave të bëra nga Instituti i Shëndetësisë, uji nuk është i pijshëm pasi që përmban një numër të konsiderueshëm bakteresh të dëmshme për shëndetin. Zgjidhja e këtij problemi shihet të jetë me anë të investimeve në impiante për filtrimin e ujit. Deri më sot është ndërtuar vetëm një impiant i cili e bën filtrimin e ujit vetëm për 15 fshatra por jo edhe për qytetin. Komuna ka tentuar që problemin e ujit ta zgjidh duke u kyçur në ujësjellësin në burimin e Drinit të Bardhë në Radavc të Istogut, mirëpo kjo nuk ka mund të arrihet shkaku i mungesës së mjeteve. Në anën tjetër, Komuna e Istogut nuk ka shprehur ndonjë interesim për bashkëpunim me arsyetim se ata vet nuk kanë sasi të mjaftueshme të ujit për të përmbushur nevojat e tyre. Qytetarët kanë kërkuar vazhdimisht nga komuna të zgjidh problemin e ujit të pijshëm, mirëpo deri më tani asgjë konkrete nuk është bërë. Banorët në qytetin e Klinës ballafaqohen me reduktime të shumta të ujit gjatë ditës, kurse në mbrëmje zakonisht nuk ka ujë fare. Prandaj, ata detyrohen të blejnë ujë për pije.

Mungesa e Stacionit te Autobusëve. Komuna e Klinës nuk ka stacion të autobusëve, gjë që shkakton probleme të mëdha për udhëtim. Banorët më së shumti shqetësohen për faktin se nxënësit e fshatrave përreth duhet të udhëtojnë shumë kilometra për të shkuar në shkollë, përderisa edhe autobusët të cilët qarkullojnë në këtë komunë nuk kane ndonjë orar të veçantë. Autobusët ndalen sipas nevojës, pa ndonjë rregull të veçantë, duke krijuar kështu edhe ngecje në komunikacion. Ndërmarrja publike “Kosovatrans” ka kërkuar leje prej KK të Klinës për shfrytëzimin e një hapësire të lirë në tregun e gjelbër të qytetit si stacion të Autobusëve, mirëpo KK i Klinës nuk e ka aprovuar një gjë të tillë.

Shërbimet Komunale. Për shkak të ndërtimit të objektit të ri të Komunës, Administrata Komunale është bartur përkohësisht në ish lokalet e QKMF-se në qytetin e Klinës, kurse disa departamente/zyra janë transferuar edhe neper objekte tjera. Kalimi i stafit të administratës në këto objekte të përkohshme është bere pa ndonjë organizim të mirëfilltë, gjë që ka shkaktuar probleme të mëdha rreth ofrimit të shërbimeve komunale për qytetarët. Banorët ankohen se gjatë kësaj kohe është shkaktuar një tollovi e madhe dhe shumë banorë nuk kanë njohuri se si apo ku të orientohen për shërbime të ndryshme komunale. Në objektin e përkohshëm nuk ekzistojnë tabela orientuese për qytetarët dhe mungojnë përshtkrimet nëpër zyret e komunës. I njëjti problem është shfaqur edhe me Gjykatën dhe Zyrën e Regjistrimit Civil. Ky problem është rritur edhe më gjatë muajve të fundit të verës pas fluksit të madh të bashkatdhetarëve nga diaspora. Qytetarët ankohen për radhë të gjata në zyrat komunale (sidomos në qendrën e regjistrimit civil) dhe shërbimeve jo-efikase nga ana e zyrtarëve komunal (vonesat e ndryshme, pauzat e zgjatura të zyrtarëve).

Ndotja e ambientit dhe mbeturinat. Ky është një problem tjetër shumë shqetësues në Komunën e Klinës. Qytetarët ankohen për deponit e shumta ilegale të mbeturinave, e sidomos për ato që gjenden afër shkollave. Deponi të tilla ndodhën afër shkollës së Volljakut dhe Përcevës. Kjo është shumë brengosëse për arsye të shëndetit të nxënësve, dhe rrezikut nga infektimet e ndryshme. Këto shkolla kanë kërkuar të paktën vendosjen e kontejnerëve për mbeturina nëpër shkolla, mirëpo Drejtoria e Arsimit është arsyetuar se nuk ka mjete për vendosjen e tyre. Ky problemet është i pranishëm në të gjithë komunën, ku çdo skaj i rrugës është i mbushur me mbeturina. Kjo është sidomos e dukshme në rrugën Volljak – Sferk ku kundërmon një erë e rëndë e mbeturinave ku edhe shpesh bëhen edhe djegie të mëdha të mbeturinave përreth rrugës. Në Komunën e Klinës vepron kompania “Ambienti” për mbledhjen e mbeturinave mirëpo kjo kompani funksionon vetëm brenda qytetit. Kur jemi te ambienti, duhet cekur se Klina ballafaqohet edhe me problemin e ujërave të zeza. Në Komunën e Klinës ujërat e zeza derdhen në lumin Drini i Bardhë dhe në lumin Klina. Kjo ka shkaktuar dëmtime të shumta në shtratin e këtyre lumenjve, zvogëlimin e sasisë së peshkut, si dhe ka ndikuar negativisht ne pjellshmërinë e tokave bujqësore që gjenden afër këtyre lumenjve. Diku rreth 15 fshatra i derdhen ujërat e zeza në lumin Drini i Bardhë dhe 15 fshatra të tjerë i derdhen ujërat e zeza në lumin Klina. Kjo është një dukuri brengosëse për banorët e kësaj komune mirëpo banorët e fshatrave nuk kane zgjidhje tjetër si pasojë e mungesës së sistemit te kanalizimit.

Ndriçimi publik i qytetit. Banorët ankohen për mungesën e ndriçimit publik në rrugët e qytetit të Klinës. Gjatë mbrëmjes në qytet pothuajse nuk ka fare ndriçim të rrugëve, përderisa pjesë të ndryshme të qytetit ndriçohen vetëm nga reklamat e

objekteve dhe lokaleve të ndryshme afariste. Shtyllat e ndriçimit të rrugëve ekzistojnë neper tërë qytetin mirëpo ato janë të vjetruara dhe nuk janë mirëmbajtur asnjëherë, kështu që asnjë prej tyre nuk funksionon.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në dy palë zgjedhjet e para lokale me komunën e Klinës ka qeverisur LDK, kurse zgjedhjet e 17 nëntorit nxorën për herë të parë në këtë komunë fituese PDK-në, e cila fitoi numrin më të madh të ulëseve të Kuvend Komunal. Edhe kandidati i PDK për kryetar komune fitoi të drejtën që të qeveris me komunën për dy vitet në vazhdim. Sokol Bashota (PDK) në raundin e parë të zgjedhjeve fitoi 4,578 vota apo 37.7%, kurse në raundin e dytë fitoi 7,242 vota apo 57.8%.

Premtimet e dhëna nga kryetari aktual Bashota, premtimet e dhëna në debatet “Jeta në Kosovë”, kishin të bënin me ujin e pijes, administratën, kulturën, etj. Një nga premtimet më të mëdha të dhëna nga z.Bashota ishte zgjidhja e problemit të ujit të pijes. Ky problem nuk ka mund të zgjidhet në këtë mandat dy vjeçar. Edhe më tutje problemi i ujit të pijes mbetet një nga problemet më shqetësuese për qytetarët.

Premtim tjetër i dhënë gjatë fushatës elektorale ka qenë edhe ndërtimi i objektit të ri të shtëpisë së kulturës. Ky premtim ka filluar së realizuari tani së voni. Pengesë në realizimin e këtij premtimi ka qenë prona kontestuese, në të cilën ka banuar një serb. Pas zgjidhjes së problemit të pronës, komuna ka rrënuar objektin e vjetër të shtëpisë së kulturës dhe përmes koncesionit ka filluar ndërtimin e një objekti të ri.

Përkundër premtimit për një administratë funksionale, mendimi i qytetarëve është se shërbimet komunale janë përkeqësuar. Sidomos me ndërrimin e objekteve të komunës, ku shumë zyre janë vendosur në objekte të ndryshme deri sa të ndërtohet objekti i ri i komunës. Disa nga premtimet dhe realizueshmëria e tyre janë pasqyruar në tabelën nr.1.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Sjellja e ujit të pijshëm me anë të krijimit të një impianti për filtrimin e ujit që do të kushtoj afër 200,000 euro, pasi që Klina fle mbi ujë dhe nuk ka ujë.	Premtimi është përbushur pjesërisht. Është përruar projekti 88,000 euro për ujësjellësin në fshatin Siçevë, atë të fshatit Krushevë e Vogël dhe rezervuari i fshatit Shturpël. Mirëpo kryetari ka dështuar në filtrimin e ujit kurse 258,000 € të dedikuara nga qeveria për impiantin për filtrimin e ujit më vonë janë tërhequr nga qeveria pasi se nuk janë shfrytëzuar.
Angazhimi i inspektor sanitar pasi që komuna nuk ka pasur inspektor sanitar.	Është realizuar. Nga muaji prill funksionon posti i Inspektoratit sanitar.
Do të rrënoj objektin e shtëpisë së kulturës dhe do të ndërtoj një objekt të ri më modern të kulturës.	Objekti ku ka qenë shtëpia e kulturës është rrënuar dhe aty ka filluar të ndërtohet një objekt tjetër me koncension, i cili do të shfrytëzohet për qëllime afariste, mbrapa tij është duke u rindërtuar edhe pallati i kulturës. Pra bashkë janë bërë objekti afarist dhe shtëpia e kulturës.
Do të luftoj korrupsionin	Nuk është vërejtur ndonjë metodë e veçantë që ka

	përdorur kryetari aktual për të luftuar korrupsionin.
Do të angazhohet të bëjë një administratë funksionale, me njerëz të përgjegjshëm. Do të eliminojë radhët e gjata para sporteve	Ky premtim nuk është realizuar. Akoma 55,000 banor të Klinës duhet të orientohen tek një person për vulosjen e dokumenteve. Administrata nuk është funksionale, para sporteve të Qendrës së Regjistrimit Civil krijohen radhë të gjata. Në këtë mes është e përfshirë edhe Ministria e Punëve të Brendshme. Po ashtu, ndodhë që shpesh zyrtarët të mos respektojnë orarin e punës.
Do të rregullojë varrezat e dëshmorëve, rregullimi i të cilave do të kushtojë 100,000 euro.	Premtimi është përmbushur.
Asfaltimi i rrugës Klinë-Shtupël	Nuk është realizuar.
Rikthimin në funksion të qumështores në fshatin Shtupël	Nuk është realizuar.
Punësimin e të rinjve dhe zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë	Nuk është realizuar.
Rregullimin e rrugës –Ranoc-Leskoc	Nuk është realizuar.
Ndërtimin e sistemit të ujësjellësit, Kanalizimit dhe ndërtimin e shkollës në Qeskovë	Nuk është realizuar.
Asfaltimi i rrugës Gllarevë-Perqevë Ujmir-Qabiq, Shtaric-Siqevë, Jashanicë-Jelloc-Resnik	Ky premtim është realizuar.

Zgjedhjet lokale në Klinë

Kuvendi Komunal i Klinës në këto tri mandate ka pasur 31 ulëse. Në dy mandatet e para qeverisëse shumicën e ulëseve në KK e ka pasur LDK. Në mandatin e parë (2000-2002) LDK ka pasur 17 ulëse, kurse në mandatin e dytë ka pasur një rënie për katër ulëse dhe rreth 2,000 vota më pak. PDK në tri legjislaturat ka mbajtur numrin e njëjtë të ulëseve, gjithnjë 10 ulëse. Por në mandatin e tretë, përkundër humbjes së më shumë se 1,500 votave, PDK arriti që të fitoj shumicën e ulëseve në KK, falë edhe dobësimit të LDK dhe ndarjes së votave në shumë parti të reja. AAK gjithnjë ka shënuar rritje në këtë komunë, ku nga dy ulëse sa ka pasur në mandatin e parë, tani ka 6 ulëse. Vetëm në mandatin e dytë në KK të Klinës është përfaqësuar një parti minoritare, “Povratka” me një ulëse. Që nga mandati i ardhshëm KK i Klinës do të ketë 27 ulëse.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Klinës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	5112	10	5226	10	4761	10
LDK	8334	17	6467	13	3237	7
AAK	1186	2	1834	4	2641	6
LDD	-	-	-	-	1602	4
AKR	-	-	-	-	431	1
PDKI	-	-	-	-	494	1
PSHDK	954	2	1367	3	491	1
ORA	-	-	-	-	234	1
“Povratka”	-	-	608	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 81.1%, në zgjedhjet e dyta kjo shifër ra në 51.36%. Në zgjedhjet e treta dalja në votime ra në 48.8%. Është interesante se sipas të dhënave të KQZ, në Komunën e Klinës votues me të drejtë vote ka pasur më pak më 2007 se sa më 2002. Këtë nuk kemi mundur të hasim në komunat tjera, pasi që për një periudhë pesë vjeçare sa ka qenë në mes zgjedhjeve të dyta dhe të treta lokale, në çdo komunë numri i votuesve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, përveç në Klinë. Në zgjedhjet e ardhshme të 15 nëntorit 2009, në Komunën e Klinës të drejtë vote kanë 36,577 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Klinë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	20964	31915	28858
Pjesëmarrja në votime	17002	16390	14085
Përqindja e daljes në votime	81.1%	51.36%	48.8%

Buxheti i Komunës

Për gjashtë vite radhazi (2003-2008), buxheti i përgjithshëm i Komunës së Klinës ka qëndruar mes shifrës 3 milion €. Vetëm në vitin 2009 është shënuar një rritje më e madhe e buxhetit të përgjithshëm dhe kjo shumë i afrohet shifrës 5 milion €. Në vitet 2006 dhe 2007 buxheti i komunës ka shënuar rënie në krahasim me vitet paraprake, kurse në të gjitha vitet tjera ka pasur ngritje. Kategoria e buxhetit e cila gjithnjë ka pasur rritje është ajo e “rroga dhe mëditje”. Edhe kategoria e shpenzimeve komunale ka shënuar gjithnjë rritje. Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake, komuna e Klinës gjithnjë ka treguar performancë negative. Përderisa pjesa më e madhe e komunave kanë arritur të realizojnë të hyrat vetanake në masën e parashikuar dhe të tejkalojnë parashikimet, Komuna e Klinës është njëra ndër komunat e pakta (së bashku me shtatë komuna tjera) e cila nuk ka arritur që të arkëtoj të hyrat në masën e paraparë. Arkëtimi është bërë në masën 97.84% dhe kjo shifër e radhitë Klinën në vendin e 23 në krahasim me komunat tjera sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake. Shpenzimi i buxhetit të përgjithshëm gjatë vitit 2008 është bërë në masën 93%.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€2,888,676	€476,515	€171,111	€55,000	€1,405,329	-	€4,996,631
2008	€2,386,803	€559,461	€152,465	€55,000	€668,759	-	€3,822,488
2007	€2,299,913	€520,923	€146,000	€49,000	€727,080	-	€3,742,916
2006	€2,298,395	€545,170	€137,511	€44,000	€757,212	-	€3,782,288
2005	€2,218,372	€431,701	€135,150	€37,839	€1,250,875	-	€4,073,937
2004	€2,039,728	€747,943	-	-	€825,718	€63,000	€3,676,389
2003	€1,612,976	€737,405	-	-	€776,353	€58,026	€3,184,760

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Klinës do të shënoj rritje edhe në vitet në vazhdim. Sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore 2010-2012 e cila është miratuar në KK të Klinës, buxheti i përgjithshëm i kësaj komune në vitin 2010 do të jetë 5.7 milion euro, ai i vitit 2011 do të jetë 5.9 milion € dhe ai i vitit 2012 do të jetë 6.1 milion €.

Investimet kapitale

Kategoria e investimeve kapitale ka shënuar rritje nga viti 2008. Në vitin 2009, nga buxheti i përgjithshëm i komunës, janë të destinuar 1,4 milion euro për investime kapitale. Kjo shifër është më e larta se në çdo vit më parë. Mirëpo, edhe pse gjatë vitit 2008 investimet kapitale kanë kapur një shifër prej afro 700,000 euro, vetëm 83% e mjeteve kanë arrit që të shpenzohen brenda vitit 2008. Lista më poshtë paraqet disa nga investimet kapitale që janë kryer në dy vitet e fundit.

Tab.5.: Investimet kapitale në Klinë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Pograxhë-Kërnice	€48,151.84
2008	Asfaltimi i rrugës Gllarevë-Perqevë	€110,286.15
2008	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Siqevë	€50,000.00
2008	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Kryshevë e vogël	€40,000
2009	Ndërtimi i trafostacionit	€44,349
2009	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Rigjevë	€86,666
2009	Asfaltimi i rrugës Jashanicë-Resnik	€78,496
2009	Ndërtimi i trotuareve Zllakuqan-Ranovc	€50,000

Kuvendi Komunal i Klinës ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Klinës do të ketë në dispozicion 6,494,277 € për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Klinës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	5,765,883	5,911,352	6,117,829
Të hyrat vetanake në €	895,164	923,582	950,223
Investimet kapitale në €	1,998,948	2,144,426	2,350,903

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Klinës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 8.8 milion € për investime kapitale.

Administrata komunale

Në tre sektorët publik komunal (administratë, arsim dhe shëndetësi) janë të punësuar 937 qytetarë. Ky numër ka shënuar rritje nga viti i kaluar dhe është numri më i madh i punonjësve në shërbimin publik komunal që kanë punuar ndonjëherë në këtë komunë.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Klinës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	937 ▲
2008	929 ▲
2007	914
2006	931
2005	933 ■
2004	933 ▲
2003	892 ■

Në administratën komunale të Klinës janë të punësuar 121 punonjës. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46, sipas së cilit në komunat me popullsi nën 100,000 banorë, komunat duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 620 banorë, del se në Komunën e Klinës numri i shërbyesve civil mund të rritet edhe për pesë punonjës deri kur të arrihet kuota maksimale prej 126 punonjësish. Shërbimet e administratës publike komunale janë një nga problemet kryesore me të cilat përballen qytetarët. Me largimin e stafit nga objekti aktual dhe vendosja e tyre në shumë objekte të ndryshme nëpër qytet, derisa të ndërtohet objekti i ri i komunës, ka bërë që qytetarët të jenë të hutuar dhe të mos dinë se ku mund të kryejnë shërbimet komunale.

Komuna e Klinës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Gjatë vitit 2008 Kuvendi Komunal i Klinës ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta, aq sa kërkohen edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Në gjashtë mujorin e parë të 2009 KK i Klinës ka mbajtur gjashtë mbledhje. KK i Klinës ka miratuar 3 rregullore komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë 2008 ka mbajtur 10 mbledhje, kurse në periudhën janar-qershor 2009 ka mbajtur gjashtë mbledhje. Edhe Komiteti për komunitete është mjaft aktiv në këtë komunë, vetëm në periudhën janar-qershor 2009 ky komitet ka mbajtur gjashtë mbledhje. KK i Klinës ka të themeluara edhe katër komitete tjera jo obligative.

Gjatë vitit 2008 Kryetari i Klinës ka mbajtur katër tubime publike me qytetarë. Ligji për vetëqeverisje lokale kërkon që në çdo komunë të mbahen së paku dy tubime me qytetarë, njëri prej tyre në gjashtëmujorin e parë të vitit. Gjatë 2009 Kryetari i Komunës së Klinës nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik, duke e shkelur Ligjin për vetëqeverisje lokale. Gjatë vitit 2008 nuk ka pasur asnjë petition të qytetarëve drejtuar komunës, por janë dorëzuar 16 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

Komuna e Klinës ka uebfaqen zyrtare në internet. Uebfaqja është e pajisur me informacione mjaftë të nevojshme aq sa një qytetari të Klinës do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës. Pasqyrimi në tabelë tregon që në ueb faqen e KK Klinë ka zbrazëti të konsiderueshme në lidhje me informacione rreth qytetit, informacione të pakta lidhur me shërbimet dhe projektet komunale.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës
(www.komuna-kline.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	3.33
Shërbimet komunale	2.2
Info rreth qytetit	2.25
Projektet komunale	2.25
Lajme & lajmërimet	3
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	3
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	3
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	3.34
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	9

Gjendja në arsim

Në Komunën e Klinës mësimi zhvillohet në nivelin fillor dhe atë të mesëm. Në këtë komunë funksionojnë 2 shkolla të mesme, 26 shkolla fillore dhe një çerdhe. Me të hyrat vetanake të komunës, Komuna e Klinës ka bërë rrethimin e shkollës së mesme “Luigj Gurakuqi” dhe rrethimin e shkollës “Motrat Qiriazit” në Klinë. Me investimet e MASHT është duke u ndërtuar një shkollë fillore. Dy shkollat e mesme të qytetit, gjimnazi “Luigj Gurakuqi” dhe SHMT “Fehmi Agani”, edhe vitin shkollor 2009/2010 e kanë filluar në një objekt të përbashkët, në mungesë të hapësirës shkollore. MASHT pati premtuar se do të investoj në objektin e ri shkollor të shkollës së mesme “Fehmi Agani” mirëpo ky projekt ende nuk ka filluar të implementohet dhe si pasojë e kësaj objekti ku mbajnë mësim këto dy shkolla është tejet i ngarkuar me nxënës dhe nuk i plotëson kushtet për mësim.

Në sytë e qytetarëve të Komunës së Klinës arsimit nuk është në nivel të duhur. Këtë vlerësim ata e bazojnë në kualitetin e ulët të mësimdhënies nëpër shkolla, mënyrën e rekrutimit të stafit na baza politike, dukuritë negative nëpër shkolla etj. Problem tjetër shqetësues për qytetarët e kësaj komune është edhe vendosja e shumë kafiterive pranë objekteve shkollore, ku nxënësit gjatë dhe pas mësimit e kalojnë tërë kohën nëpër këto kafeteri.

² (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Gjendja në shëndetësi

Në komunën e Klinës funksionon një QKMF (Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare), tri QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare), si dhe dhjetë AMF (Ambulanca të Mjekësisë Familjare). Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin shëndetësor është 138. Sipas strukturës gjinore meshkuj janë 64 të punësuar ndërkaq femra 74. Sipas strukturës nacionale 136 janë shqiptarë ndërsa 2 të punësuar janë të tjerë (të komuniteteve pakicë). Nga ky numër i përgjithshëm 15 janë specialistë, 14 mjek të përgjithshëm, 1 stomatolog, 79 motra medicinale, 10 punëtor administrativ, 11 punëtor ndihmës dhe 8 shoferë. Këtë vit për herë të parë në komunën e Klinës është hapur reparti i gjinekologjisë në kuadër të QKMF të Klinës. Në këtë komunë janë në dispozicion 2.5 mjek për 1,000 banorë.

Nëpër punktet shëndetësore nëpër fshatra qytetarët ankohen se mjeku nuk mban vizita të rregullta, nuk respektohet orari i punës dhe higjiena është në nivel të dobët. Edhe lista esenciale e barnave nuk respektohet në këtë komunë dhe kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe drejtorisë komunale për shëndetësi. Për raste më të rënda qytetarët e Klinës u duhet që të vizitojnë spitalin regjional në Pejë.

Shoqëria civile

Në komunën e Klinës ka shumë organizata jo qeveritare aktive. Fokusi kryesor i organizatave jo qeveritare që janë aktive është avancimi i pozitës së gruas dhe promovim të aktiviteteve rinore. Por nuk ka organizata të cilat në mënyrë aktive monitorojnë punën e trupave komunale. Organizatat të cilat fokus të tyre kanë avancimin e pozitës së gruas në shoqëri janë organizatat “Zana”, “Elena Gjika”. Organizatat të cilat fokus të tyre kanë rininë janë “Ardhmëria” dhe “4 dëshirat”.

Mediat lokale

Në komunën e Klinës është aktive një radio lokale, Radio Alba. Kjo radio bën monitorimin dhe raportimin për punën e Kuvendit Komunal. Përveç radios, për këtë komunë raportojnë edhe korrespondentët e të përditshmeve “Koha Ditore”, “Zëri”, “Infopress”.

Rendi dhe ligji në Komunën e Klinës

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Klinës kanë ndodhur 1518 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 55 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Klinë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	274
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	52
Pengim i personave zyrtar në	7

kryerjen e punës	
Vjedhje e pyjeve	25
Incidente lidhur me pronën	64
Vjedhje	183
Abuzime seksuale	2
Shkaktim të dëmtimeve trupore	48
Kërcënime	34
Mashtrime	9
Vrasje	9
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, Kuvendi Komunal i Klinës ka miratuar edhe Rregulloren komunale për tatim në pronë në bazë të së cilës pronat ndahen në tri zona dhe norma tatimore sillet nga 0.15% deri në 0.20%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Klinës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banasa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.20%	0.20%	0.20%	0.15%	0.15%
I	300	300	500	400	300
II	200	200	400	300	200
III	150	150	200	200	200

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Klinës funksionojnë rreth 1,300 biznese. Shumica e tyre janë mikro biznese dhe i adresohen veprimtarisë tregtare, ndërtimtarisë, transportit, shërbimeve hoteliere, zejтари dhe riparime, shërbime shëndetësore dhe sociale. Tabela më poshtë pasqyron shumën që disa nga bizneset duhet të paguajnë për leje pune.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	500 €
Kompanitë e sigurimit	500 €
KEK	500 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	500 €

Industria metalurgjike dhe kimike	500 €
Agjensionet turistike	200 €
Hotelet	500 €
Motelet	400 €
Supermarketet-Hipermarketet	200 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	120 €
Restorant	200 €
Telekomunikimit	120 €
Barnatoret	120 €
Autoshkollat	200 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50 - 100 €
Depot me shumicë	400 €
Pompat e benzinës	400 €
Ndërmarrjet ndërtimore	200 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	100 - 150 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
14. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.